

**VENDIM**  
**Nr. 219, datë 1.9.2022**

**MBI RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 240, DATË 21.12.2020,  
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘ERDY ENERGY’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘KALIS’ ME KAPACITET TË  
INSTALUAR 2138 kw”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 1.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1504 prot., datë 29.8.2022, “Mbi rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 240, datë 21.12.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Erdy Energy’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Kalis’, me kapacitet të instaluar 2138 kw”, konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 240, datë 21.12.2020, ka vendosur të licencojë shoqërinë “Erdy Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kalis”, me kapacitet të instaluar 2138 kw, për një afat 30-vjeçar. Referuar pikës 4 të këtij vendimi, shoqëria ka detyrimin që pas përfundimit të afatit të lejes së përdorimit të burimit ujqor (datë 25.4.2022), të depozitojë lejen me afate të rifreskuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit të saj.

- Referuar përcaktimeve të pikës 4, të vendimit nr. 240/2022, ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 389 prot., datë 18.3.2022, duke i kërkuar informacionin përkatës mbi aplikimin për rinovimin e lejes së përdorimit të burimit ujqor në kuadër të plotësimit të kushtit të këtij vendimi.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 389/1 prot., datë 18.4.2022, shoqëria ka bërë me dije se ka aplikuar pranë Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore (AMBU) dhe është në pritje të shqyrtimit të kërkesës së saj, ndërsa me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1340 prot., datë 29.7.2022, shoqëria ka depozituar vendimin dhe lejen e lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujqor Shkumbin (KBU), për prodhim hidroenergjie nga HEC “Kalis”. Në këtë leje përcaktohet se periudha e vlefshmërisë është 5 vjet dhe hyn në fuqi pas publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve.

- Sikurse publikuar në regjistrin e subjekteve që disponojnë leje/autorizim të vlefshëm për përdorim burimi ujqor për prodhim hidroenergjie, të aksesuar *online* në adresën: [www.ambu.gov.al](http://www.ambu.gov.al), rezulton se data e përfundimit të lejes së përdorimit të burimit ujqor për HEC “Kalis” është 4.7.2027.

- Për sa më sipër vlerësohet që të ndryshohet kushti i vendosur në pikën 4 të vendimit nr. 240/2020, duke i lënë shoqërisë detyrimin që të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor, jo më vonë se data 4.7.2027.

- Gjithashtu, për qëllime të unifikimit të kushteve të vendimit nr. 240/2020 dhe vendosjes së një afati, për sa i përket kushtit të vendosur në pikën 3 të këtij vendimi, vlerësohet rishikimi i pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi.

- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti administrativ, me nismën e vet organit, që ka nxjerrë aktin, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

## VENDOSI:

1. Pikat 2, 3 dhe 4 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 240, datë 21.12.2020, ndryshojnë si vijon:  
“2. Shoqëria “Erdy Energy” sh.p.k. të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë me Bashkinë Librazhd, jo më vonë se data 21.10.2025.
3. Shoqëria “Erdy Energy” sh.p.k. të depozitojë në ERE informacion/dokumentacion mbi statusin e aplikimit për heqjen nga fondi pyjor bazuar në komunikimet shkresore me autoritetet përgjegjëse, brenda 3 muajve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Shoqëria “Erdy Energy” sh.p.k. të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor, jo më vonë se data 4.7.2027.”.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.
- Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Petrit Ahmeti**